

VENDIM
Nr.242, datë 6.3.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 436 (katërqind e tridhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Krujës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Krujë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,7,8,10,11,12,13,15,16,20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
32-48	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
49-51	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale.	Në pronësi
55-59	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
68,73,81	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë jobujqësore.	Në pronësi
65,66,67,69,70,71,72,79, 80, 82,83,84	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore.	Në përdorim
264-318	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
319-323, 337	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit.	Në pronësi
346-351	Varrezat publike	Në pronësi
420-426,428,429	Infrastrukturë (troje dhe sheshe)	Në pronësi
74,75,76,77,78,419	Zhvillim ekonomik	Në pronësi
427,430,431	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim